

## Besa DOGANI

# NDIKIMET POLITIKE NË KULTIVIMIN E TRASHËGIMISË KULTURORE SHQIPTARE NË MAQEDONINË E VERIUT

UDC 930.85(497.7:=18)

**Abstrakt:** Grupet kryesore etnike në Maqedoni, mes tjerash, e ndajnë organizimin e përbashkët patriarchal të familjes. Prandaj, këto popuj jetojnë në parakushte të njëjtë për sa i përket kultivimit të trashëgimisë kulturore, por përkujdesja institucionale e pafavorshme për shqiptarët ka bërë që në këtë fushë të ketë dallime zhvillimore midis etnive të ndryshme.

Duke jetuar në këto qarqe të mbyllura ata kanë pasur shumë pak mundësi për të qenë të ndikuar nga jashtë dhe u kanë qëndruar besnik bindjeve të tyre të kultivuara me vite, të cilët shpeshherë konsiderohen si të prapambetura, të mbyllura ndaj ndryshimeve, plot me paragjykime dhe mosbesim, që në shumë raste konsiderohen të jenë në kufi të demokracisë.

Duke marrë parasysh faktin që për shkak të fuqisë së dobët ekonomike dhe mundësive të pakta për zhvillim, shqiptarët e sidomos ata të Republikës së Maqedonisë të cilët kanë pasur shumë pak përkujdesje institucionale, shumë pak rëndësi i kanë dhënë trashëgimisë kulturore dhe ruajtjes dhe kultivimit të saj.

Po ashtu nëse kësaj i shtohet edhe periudha e gjatë në të cilën shqiptarët e këtyre trojeve kanë jetuar nën pushtim apo trysni të sistemit politik komunist, mund lirisht të thuhet se trashëgimia kulturore është shumë e paktë e sidomos në formë të dokumentuar.

Pjesa më e madhe e trashëgimisë kulturore është ruajtur përmes këngëve, gojëdhënavë, rrëfenjave, siç janë ritualet e dasmës në rajone të ndryshme (Kërçovë, Kumanovë, Rekë e epërme), Pehlivanët në Studeniçan, Karnavalet e Bozovcës, si pjesë e trashëgimisë jomateriale. Trashëgimi materiale ka shumë pak dhe ndër to mund të veçojmë Shtëpinë e Kongresit të Manastirit, Kalanë e Tetovës dhe disa monumente të periudhës osmane.

Përpos përpjekjeve të disa mediave që të aktualizojnë trashëgiminë kulturore dhe të ngritin vetëdijen e përgjithshme për rëndësinë e ruajtjes dhe kultivimit të saj, nuk ekziston ndonjë Ligj apo rregulllore për ruajtjen e trashëgimisë kulturore. As që ka ndonjë nismë për krijimin e koleksionit kombëtar të trashëgimisë së luajtshme, digjitalizimin e trashëgimisë kulturore në përbledhje shënimesh, inventarizimin dhe dokumentimin digjital të trashëgimisë kulturore, apo masa të ngashme.

Ky punim ka për qëllim që me shembujt praktik që do të shtjellohen në të, të bëj një vështrim krahasues të gjendjes së trashëgimisë kulturore në Maqedoni para ndikimit të epokës digitale dhe periudhës aktuale dhe të konstatojë nëse një ndikim i tillë ekziston dhe nëse ka arritur të sjell kultivimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore në një nivel më të lartë dhe të jep propozime dhe udhëzime përmirësimin e gjendjes së konstatuar.

**Fjalët kyçe:** trashëgimia kulturore, epoka digitale, kultivim, fuqia ekonomike

Zhvillimi kulturor i të gjithë bashkësive etnike që jetojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut përherë ka qenë një imperativ, së paku i shënuar në legjislacionin e vendit dhe i propaganduar nga institucionet shtetërore. Realisht kjo është e drejtë shumë e natyrshme, sepse, në fakt, të gjithë etnitë me veçoritë e tyre gjuhësore, kulturore dhe etnike kanë kontribuuar me shekuj për pasurimin e thesarit kulturor në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Edhe pse trashëgimia kulturore në RMV paraqet një bazë të mirë për zhvillimin e modelit shumë kulturor e shumetnik, për një mënyrë tjetër jetese në vend dhe për plotësimin e zbrazëtirave e ndasive që ekzistojnë në mes të popujve, ndodh e kundërtë, e kjo si pasojë e mosnjohjes së traditës dhe kulturës së tjetrit. Për shkak të interesave të ndryshme politike, ekonomike dhe për shkak të synimit të etnititetit maqedonas, respektivisht të udhëheqësve të institucioneve që i takojnë etnititetit maqedonas që ta përvetësojnë Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe ta prezantojnë si shtet e vend vetëm i maqedonasve, për dhjetëvjeçarë ndodh marginalizimi kulturor, viktivë e të cilit kryesisht ka qenë kultura, gjuha, tradita dhe trashëgimia shqiptare në përgjithësi. Me këtë anashkalim është tentuar dhe, deri diku, është arritur që të lihet nën hije një pasuri e rajonit dhe të vetë Evropës, sepse vetëm si e tillë mund të karakterizohet trashëgimia kulturore e shqiptarëve.

Kështu në Republikën e Maqedonisë së Veriut, nëpërmjet projektit qeveritar të njojur si “*Shkupi 2014*” u vu nën hije jo vetëm trashëgimia kulturore e shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut, por edhe të gjithë etnive tjera që jetojnë në këtë shtet, ndërkaq u vendos në sipërfaqe kultura e lashtë greke dhe kultura sllave serbe, e cila ka shumë pak të bëj me këtë territor gjografik.

Nga ana tjetër, për një periudhë disavjeçare u ndanë mjete të shumta financiare nga buxheti i shtetit për realizimin e projekteve që kanë të bëjnë me digitalizimin e trashëgimisë kulturore, sidomos asaj letrare dhe jo materiale, përmes hapjes së bibliotekave digitale dhe muzeve kombëtare maqedonase, ndërkoqë që shqiptarët kalonin fazën më të errët të historisë së tyre: me mungesë të librave shkollorë dhe me përbajtje të shtrembëruara në librat ekzistues.

Kur jemi te librat shkollorë mund të themi që krahas me mungesën e kapaciteteve për ruajtjen e trashëgimisë kulturore, ngritura e të cilëve në masë të madhe varet nga fuqia ekonomike dhe përkujdesja financiare shtetërore, është e dukshme mungesa e një teksti shkollor, doracaku, përmes të cilit do të arrihej ngritura e vetëdijes dhe edukatës tek gjeneratat e reja, që nga mosha më e hershme, për trashëgiminë kulturore si dhe rolin e saj. Në këtë drejtim mund të themi që sërisht fajtor është karakteri etno-centrik i Republikës së Maqedonisë së Veriut, sepse fushata të tillë për ndërgjegjësim ka pasur shumë, por fatkeqësisht ka qenë e drejtuar vetëm për maqedonasinë dhe kulturën e tyre.

Duke qenë gjithnjë të shkelur në aspekt institucional dhe ekonomik, duke kërkuar kafshatën e gojës në mërgim dhe, natyrisht, duke i pranuar prirjet bashkëkohore digitale, shqiptarët e Maqedonisë së Veriut gjithnjë e më tepër kanë humbur interesimin për ruajtjen dhe për kultivimin e veshjeve kombëtare, traditave popullore, dasmave, traditave mortore, këngëve e deri te ruajtja e vlerave arkitektonike. Kundrejt kësaj edhe nga ana e hulumtuesve dhe njerëzve të shkencës, trashëgimia e shqiptarëve në këto treva nuk është studiuar sa duhet. Kjo trashëgimi e begatshme e shqiptarëve në këto treva nuk është studiuar për shkak se nuk ka pasur institucionë të mirëfillta dhe shqiptarët gjithnjë kanë qenë nën okupimin e ndonjë shteti apo ndonjë forcë tjetër. Mos studimi i trashëgimisë mund të ndërlidhet ngushtë edhe me faktin se ekziston mungesë e kuadrove profesionale dhe të rinxje të interesuar për studime të kësaj fushe. Së këndejmi dëgjojmë shumë pak për arkeologë apo historianë të artit në mesin e shqiptarëve të Maqedonisë. Për këtë dëshmon edhe fakti se në katedrën e antropologjisë kulturore studiojnë shumë pak ose aspak shqiptarë. Pa profesionistët dhe për shkak të moskujdesit të duhur, zbulimit, menaxhimit dhe ruajtjes së artefakteve, detaje të rëndësishme humbasin çdo ditë e më tepër.

Në këtë drejtim shpeshherë në mesin e akademikëve është hedhur ideja për formimin e një Këshilli të përbashkët për të njësuar qëndrimet dhe për të hartuar programe strategjike për parandalimin e rrezikimit të vlerave kombëtare dhe fetare të shqiptarëve të Maqedonisë. Deri tanë përpos themelimit

të Institutit për Trashëgimi Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve, shumë pak është bërë në këtë drejtim.

Trashëgimia kulturore e shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut është shumë e larmishme dhe, me këtë rast, do të përmend vetëm disa të cilët meqë fituan mbështetje institucionale mund të thuhet se iu shmangën vellos së harresës. Të tilla janë: ritualet e dasmës në Kërçovë, traditat në rajonin e Kumanovës, Pehlivaniët në Studeniçan, Karnavalet ilire të Bozovcës, që tani janë futur, sado pak, nën ombrellën e mbrojtjes së trashëgimisë jomateriale.

Megjithatë mungojnë dëshmitë e ndryshme kulturore si monografi me dokumente, fotografi dhe dëshmi për familjet shqiptare në Shkup, sidomos ato katolike. Një prej tyre është muzeu i Shtëpisë së Alfabetit, në të cilin ka shumë pak dokumente dhe dëshmi të ruajtura.

Mungesa e madhe në sferën e mbrojtjes së trashëgimisë jomateriale është reflektuar në numrin e vogël të thesareve të kulturës shqiptare, që janë të regjistruara si të tilla në Regjistrin Nacional të Pasurive. Kjo është një prej arsyeve që për shumë prej tyre as që është e mundur që të aplikohet për të realizuar projekte më të mëdha për mbrojtjen e tyre nga zhdukja.

Përfundimisht, është më se e qartë se faktori kryesor për këtë mungesë të trashëgimisë së ruajtur kulturore mbetet mungesa e përkujdesjes institucionale, mospasja e institucioneve përkatëse dhe moskëmbëngulja për krijimin e kuadrove të reja në këtë fushë. Nuk duhet të harrohet që mosinteresimi për ruajtjen e trashëgimisë kulturore, pa dyshim, vjen edhe si pasojë e globalizimit, i cili paraqet kërcenim për vlerat kulturore, fetare dhe historike dhe se duhet të bëhen përpjekje më të mëdha për ruajtjen e këtyre të fundit.

Duke konstatuar qartë që llojet e ndryshme të trashëgimisë janë të cenuara skajshmërish, të gjitha institucionet e shtetit, individët, organizatat e shoqërisë civile, universitetet, institucionet tjera kulturore dhe arsimore duhet të bëjnë përpjekje maksimale për përkujdesen dhe të kenë qasje shumë më serioze ndaj etnokulturës shqiptare, me qëllim që trashëgimia kulturore kombëtare të ruhet në gjendjen e saj burimore.